



Kanton Bern
Canton de Berne

hallo-bern.ch
salut-berne.ch

Puna

Hyrja në tregun e punës

Me gjetë punë

Të drejtat dhe detyrimet

Papunësia

Njohja e diplomave

hallo-bern.ch

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri

Puna



Hyrja në tregun e punës

Mvaret prej përkatësis shtetërore dhe arsyes të ardhjes se a mundet dikush të punoj apo themeloj një ndërmarrje në Zvicër. Në çdo rast duhet punëtorët të lajmërohen te sigurimet sociale dhe të paguhet tatimi.

Leja e punës

Pyetja për lejen e punës zakonisht sqarohet përnjëherë me dhënjen e leje qëndrimit. Në rastin normal personat me të drejtë leje qëndrimi në Zvicër munden edhe të punojnë. Sipas përkatësis shtetërore dhe kohëzgjatja e punës, kërkesën për leje të punës e bënë punëdhënësi apo punëtori. Nëse nuk dihen procedurat, mundet një prej vendeve të mëposhtme të ndihmoj më tutje. Këto vende këshillojnë edhe personat, të cilët ende nuk banojnë në Zvicër dhe që duan këtu të punojnë. Refugjatët e pranuar (letërnjoftimi B) dhe personat e pranuar përkohësisht me apo pa status për refugjatët (letërnjoftimi F) që nga viti 2019 nuk ju nevojitet më leje-qëndrim special. Mirëpo, gjdo fillim dhe mbarim i punësimit duhet të lajmërohet me një formular zyrtar në kanton. Procedura e lajmërimit (Njoftim i detyrueshëm | Meldepflicht | procédure d'annonce). Përgjegjës është kantoni ku njeriu punon. Kjo paraqitje është falas. Azilkërkuesëve (letërnjoftimi N) ju nevojitet leja.

Ndërmarrja vetanake

Se a mundet dikush në Zvicër ta themeloj një ndërmarrje të veten, mvaret prej përkatësisë shtetërore dhe nga leja e qëndrimit. Për personat nga vendet e EU/EFTA dhe për personat me leje qëndrimi C, themelimi i një ndërmarrje është më i lehtë. Njeriu duhet punën vetanake ta lajmëroj në komunën ku banon. Personat nga shtetet e tjera EU/EFTA duhet ta bëjnë një kërkesë me shkrim. Zyra për Migrim, (Migrationsdienst | service des migrations) informon emigrantet dhe emigrantët mbi atë, se a është i mundur themelimi i një ndërmarrje vetanake. Kush don të punoj i pavarur, duhet te AHV- Pensioni i pleqërisë te kasa familjare për shtesat e fëmijëve, shtesat për shkollim si dhe eventualisht sigurimi kundër aksidenteve si dhe te kasa për pension (trusti) të lajmërohen vet.



Puna në të zezë

Secila punë që paguhet duhet te zyrtarët përgjegjës të lajmërohet. Kush punon dhe nuk është i lajmëruar te sigurimet sociale nuk ka leje të punës, apo nuk i deklaron parat për tatim, e bënë veten të dënueshëm. Njeriu flet këtu për punë në të zezë. Puna në të zezë ka konsekuenca me ligj, si për punëdhënësin edhe për punëmarrësin. Përveç kësaj punëtorët nuk janë të siguruar kur mbesin të pa punë, kundër aksidenteve dhe invaliditetit, si dhe nuk kanë ndalesa për pension në pleqëri. Kush beson se punëdhënësi e trajton jo korrekt, do të duhej të shkoj në një këshillimore për drejtësi e cila është falas (Rechtsberatungsstelle | bureau de conseil juridique).

Të rinjët

Të rinjët tek kur t`i mbushin 15 vjet, guxojnë të punojnë. Punë të lehta me kohëzgjatje të vogël (p.sh. punë gjatë pushimeve) janë të lejuara. Prindërit dhe punëdhënësit janë të detyruar të kujdesën që të rinjët të mos mbingarkohen. Për të rinjët deri 18 vjeç vlejnë të drejta të posaçme në punë.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/puna/hyrja-ne-tregun-e-punes



Me gjetë punë

Në krahasim me vendet e tjera në Zvicër ka vetëm pak të papunë. Megjithëkëtë punëkërkuuesit duhet të plotësojnë kërkesa të larta. Dëftesat dhe diplomat kanë domethënie të madhe. Njohurit në gjuhën gjermane apo frënge janë parakusht i rëndësishëm pothuajse për çdo vend të punës.

Kualifikimet

Profesionet e përfunduara, diplomat dhe kualifikimet e mëtejme kanë në Zvicër gati në të gjitha profesionet vlerë të lartë. Diplomat e huaja nuk pranohen çdoherë. Shumë të rëndësishme gjatë kërkimit të një pune janë edhe dëftesat e punës të punëdhënësit të mëhershëm. Për shumicën e vendeve të punës, njohurit në gjuhën gjermane apo frënge janë të nevojshme. Ngase kantoni i Bernit ka këto dy gjuhë zyrtare, nganjëherë priten njohuri në të dy gjuhët.

Me gjetë një vend pune

Ofertat e vendeve të punës i gjen njeriu në gazeta ditore edhe në portale të ndryshme të internetit. Në portalet e internetit mundet njeriu të paraqitet për abonamente kërkuese, të cilat janë falas. Tutje ka zyra private ndërmjetësuese për punë. Në Zvicër nuk është e jozakonshme me thirr me telefon në një firmë dhe me pyet për punë. Kjo është e mundshme, edhe kur kjo firmë nuk ka shpallur konkurs për një vend të lirë të punës. Qendrat publike rajonale për ndërmjetësim në punë (RAV | ORP) munden me ndihmë gjatë kërkimit të një vendi të punës. Aty ka kompjuter dhe gazeta ditore në dispozicion dhe punonjësit i këshillojnë punëkërkuuesit. Njeriu do të duhej t`iu tregoj shumë personave, që është duke kërkuar punë. Kontaktet personale mund të ndihmojnë shumë në gjetjen e një pune.

Aplikimi

Për një vend pune aplikon njeriu normalisht me shkrim. Për një aplikim duhet më së paku një biografi (CV), një shkresë për motivim dhe nëse është e mundshme një kopje nga dëftesat përfundimtare, diplomat dhe dëftesat e punës. Në shkresën për motivim sqaron njeriu, pse është i interesuar për këtë vend pune dhe pse është personi i duhur për këtë punë. Nëse punëdhënësi është i interesuar, njeriu do të ftohet për një bisedë prezantimi personal (Vorstellungsgespräch | Entretien d'embauche). Për këtë bisedë njeriu do të duhej patjetër mjaftueshëm të përgatitet. Vende të ndryshme ofrojnë mbështetje falas, për përgatitje për aplikim.



Kanton Bern
Canton de Berne

hallo-bern.ch
salut-berne.ch

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/puna/me-gjete-pune

hallo-bern.ch

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri

Puna

Të drejtat dhe detyrimet

Të punësuarit dhe punëdhënësit kanë të drejta dhe detyrime të ndryshme. Me ligj janë të rregullura p.sh. koha maksimale e punës, e drejta për pushim, dhe sigurimi mbrojtës.

Kontrata e punës

Në rastin normal kontratat e punës bëhen me shkrim. Mirëpo edhe kontratat me gojë janë të vlefshme. Vlejnë vendimet ligjore të drejtës obligative (Obligationenrecht | Droit des obligations). Në të janë standardet kryesore. Prandaj edhe personat pa kontratë pune kanë të drejta të ndryshme, mirëpo dhe detyrime.

Të drejtat e punëmarrësve

Punëmparrësit kanë në Zvicër të drejta ligjore të ndryshme. Nga më të rëndësishmet janë:

- unëdhënësit janë të detyruar, punëtorët e tij t'i lajmëroj te sigurimet sociale, ta bëjë sigurimin për aksident dhe një pjesë të shumës për këto sigurime ta paguaj.
- Të gjithë të punësuarit kanë të drejtë më së paku për katër javë pushim me pagesë. Kjo vlen edhe për personat, që janë me rrogë që paguhen me orë apo ata që punojnë orare jo të plota.
- Koha më e lartë e lejuar për punë është 50 orë në javë. Në disa firma janë vetëm 45 orë dhe në disa të tjera janë orare më të gjata të punës të lejuara.
- Të punësuarit kanë të drejtë për një dëftesë-vlerësuese të punës të tij me shkrim.
- Kush sëmuret apo ka pasur ndonjë aksident dhe që ka punuar më shumë se tre muaj në firmë, ka për një kohë të drejtën e marrjes të rrogës.
- Gratë shtatëzëna dhe gratë, që kanë lindur një fëmijë kanë të drejta të posaçme (mbrojtja për nënë).

Rroga

Në Zvicër nuk ka ligji për rrogë minimale. Mirëpo shumë firma kanë një kontratë pune të përbashkët (GAV | CCT), në të cilat është e përcaktuar rroga minimale. Gratë dhe burrat kanë të drejtën për rroga të njëjta për punë të njëjtë. Në kontratë është e vendosur shuma e rrogës bruto. Paguhet rroga neto, pasi që janë zbritur shumat për sigurime sociale (Sozialabzüge | Déductions sociales). Te personat me leje qëndrimi B, me letërnjoftim F apo N, leje qëndrim i shkurtër L, leje kalimi i kufirit G, zbriten shumat për sigurime sociale direkt nga rroga nga zyra për tatime burimore (Quellensteuer | Impôt à la source).



Largimi nga puna

Te largimi nga puna, duhet punëdhënësi dhe punëmarrësi tu përmbahen rregullave të vlefshme për kohën në kontratë. Largimi i menjëhershëm nga puna është i mundshëm vetëm në raste përjashtuese. Njeriu mundet çdoherë ta kërkoj me shkrim arsyen e largimit nga puna. Kush është i sëmurë, ka pasur një aksident, është shtatëzënë ose ka lindur një fëmijë, është special i mbrojtur nga largimi prej punës. Nëse punëmarrësi vet largohet nga puna, mundet me ndikue në lartësin e mbështetjes prej sigurimit për të papunët.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/puna/te-drejtat-dhe-detyrimet



Papunësia

Në parim, të gjithë të punësuarit që jetojnë në Zvicër janë të siguruar kundër papunësisë. Ata që mbeten të papunë zakonisht marrin mbështetje financiare për një periudhë të caktuar kohe. Personat e papunë mund të regjistrohen personalisht në qendrën rajonale të ndërmjetësimit për punë (RAV | OPR) ose elektronikisht përmes platformës online www.arbeit.swiss. Kjo do t'ju ndihmojë kur kërkon punë.

Sigurimi i të papunëve

Sigurimi i të papunëve (ALV | AC) është një sigurim shtetëror dhe për të gjithë të punësuarit i detyrueshëm. Shumat mujore zbriten direkt nga rroga, punëdhënësi merr gjysmën përsipër. Të pavarurit nuk mund të sigurohen te sigurimi i të papunëve. Kush mbet pa punë, merr prej një kase për të papunët një pagë mujore zëvendësuese para për të papunët, (Arbeitslosengeld | allocation chômage). Nëse, kur, dhe në çfarë shume paguhen parat për të papunët, mvaret prej shumë faktorëve. Për shembull, sa gjatë ka punuar njeriu, apo për çfarë arsye ka mbetur i pa punë.

Veprimi gjatë papunësisë

Nëse jeni të kërcënuar nga papunësia, regjistrohuni sa më parë të jetë e mundur, por jo më vonë se në ditën e parë të papunësisë.

Qendra rajonale e ndërmjetësimit për punë

Qendra rajonale e ndërmjetësimit për punë (RAV | OPR) ndihmon në atë, për ta gjetë përsëri shpejt një punë. Bisedat këshilluese në RAV janë të detyrueshme, kur njeriu tërheq para për të papunët. RAV | OPR ofron kurse dhe programe për të përmirësuar kushtet e tërheqjes së tregut të punës. Në kushte të caktuara, këto mund të vizitohen edhe nga persona që nuk kanë të drejtë për përfitime papunësie. Edhe personat që nuk kanë punuar kurrë në Zvicër dhe janë në kërkim të një pune mund të regjistrohen në RAV | OPR. Por këta persona nuk do të marrin para.

Përfitimet në rast papunësie

Përfitimet e papunësisë (ALE) janë një mbështetje financiare për punëkërkuesit që janë të regjistruar në RAV | OPR dhe kanë të drejtë të kërkojnë këto përfitime. Ky përfitim i paguhet direkt klientit të RAV|OPR nga fondi përkatës i sigurimit të papunësisë.



Kanton Bern
Canton de Berne

hallo-bern.ch
salut-berne.ch

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/puna/papunesia

hallo-bern.ch

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri

Puna



Njohja e diplomave

Diplomat e jashtëvendore dhe përfundimet shkollore nuk janë çdoherë në Zvicër të vlefshme. Sipas rrethanave është e mundëshme, që diplomat të procedohen për njohje. Për disa profesione kjo kërkohet detyrimisht patjetër.

Njohja

Personat me diplomë të huaj munden ta procedojnë njohjen në Zvicër me disa kushte. Me njohje vërtetohet, që diploma e huaj, apo një tjetër përfundim i shkollës është njësoj i vlefshëm me diplomën apo përfundimin shkollor të Zvicrës. Te profesionet me kualifikim (p.sh njerëzit për përkujdesje mjekësore, personat mësimor etj.) njohja është e nevojshme, për me mund me e ushtruar profesionin. Për njohje janë sipas profesionit apo arsimimit zyrtar kontaktuese të ndryshme përgjegjëse. Njohja kushton. Për pyetje të përgjithëshme për njohjen e diplomave të huaja është sekretariati i shtetit për arsim, hulumtim dhe inovacion (Staatssekretariat für Bildung, Forschung und Innovation SBFI | Secrétaire d'État à la formation, à la recherche et à l'innovation SEFRI) përgjegjës.

Vërtetim mbi nivelin e arsimimit

Te profesionet që mund të ushtrohen pa kualifikim, nuk është e nevojshme njohja e diplomës apo e përfundimeve tjera shkollore për me punue në Zvicër. Për këto profesione mundet me u bë kërkesa për një vërtetim nivelin arsimor (Niveaubestätigung|Attestation de confirmation de niveau). Kjo tregon vlerësimin e diplomës të huaj me atë të sistemit arsimor në Zvicër. Ky vërtetim mund të ndihmoj gjatë kërkimit të një vendi pune. Informacione për vërtetim nivelin arsimor e bëjnë vendet kontaktuese nacionale për njohje të diplomave (Nationale Kontaktstelle für Diplomanerkennung | Point de Contact national pour la reconnaissance de diplômes), apo këshillimoret për profesione- dhe qendrat informative (Berufsberatungs- und Informationszentren BIZ | Centres d'orientation professionnelle OP).



Përmbyllja e një profesioni

Të rriturit me përvojë në një profesion, mirëpo pa diplomë të njohur apo pa njohje të përfundimeve tjera shkollore, mundën ta përsërisin shkollimin për të arritur një përfundim shkollor zviceran: arsimim bazë profesional apo arsimim profesionl të lartë. Ecuria mvaret prej arsimimit të mëhershëm, prej përvojës në profesion dhe moshës. Në çdo rast është njohja e gjuhës gjermane si parakusht (niveli B1/B2 sipas GER). Të interesuarit mundën p.sh te këshillimorja për profesione- dhe qendrat informative BIZ (BIZ | OP) të informohen dhe të këshillohen falas. Kush e përsërit dhe e bënë përmbylljen e një profesioni, i përmirëson gjatat e veta në tregun e punës dhe ka çasje në arsimim e mëtutjeshëm.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/puna/njohja-e-diplomave